



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Municipality of Istog

01 Nr. 368/2018  
Më: 06.07.2018

<https://kk.rks-gov.net>  
Tel: 038/200-43814

**Kryetari i Komunës, në bazë të Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret , Standardet dhe Programet e financimit publik të OJQ-ve:**

### **Fton**

Të gjitha OJQ-të që veprojnë në Komunën e Istogut për ofrimin e shërbimeve të fizioterapisë që të aplikojnë:

#### **1. Ofrimin e shërbimeve të fizioterapisë në shtëpi për persona me aftësi të veçanta.**

Propozimi duhet të përmbajë në mënyrë të qartë:

Objektivat, aktivitetet dhe buxhetin. Duhet të jetë sa më i specifikuar dhe në të përshkruhen në mënyrë të detajzuar aktivitetet, vendi se ku do të realizohen këto aktivitete.

**Përparësi do të kenë këto Organizatat që :**

1. Organizatat që kanë dëshmi për aktivitete të tilla.
2. Përparësi do të kenë projektet të cilat e kanë përshkrimin e qartë dhe buxhetin e specifikuar.
3. Përparësi do të kenë organizatat që janë nga Komuna e Istogut .

**Projekt-propozimi i dorëzuar duhet të përmbajë :**

- Në projekt duhet të përfshihen lokacioni, kohëzgjatja e implementimit, aktivitetet etj.
- Projekt propozimi duhet të jete i kufizuar deri në 5.000 euro.
- Një kopje që posedon regjistrimin e OJQ - së, kopjen e certifikatës fiskale
- Një kopje të llogarisë bankare të OJQ-së dhe kopjen e letërnjoftimit të menaxherit të projektit.

Projektet nuk do të përkrahen nëse nuk kanë përputhshmëri me kriteret e kësaj thirrje .

**Afati përfundimtar për dorëzimin e propozimeve është 21.07.2018**

**Aplikuesit e propozimeve që aplikojnë pas kësaj date nuk do të shqyrtohen dhe ato duhet të dorëzohen në zyrën për shërbim me qytetarë, nr. 100.**



Kryetari i Komunës  
Haki RUGOVA